



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Datë: 24.09.2025
Numër Protokolli: 5383/2025

A.nr.1145/2025

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Flakron Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurën sipas ankesës me numër A.nr.1145/2025, të datës 16.06.2025, të parashtruar nga ankuesja V.M, nga Prishtina, kundër Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, bazuar në nenin 50 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 24.09.2025, mori këtë:

V E N D I M

I.Korrigjohet Vendimi A.nr.1145/2025 i datës 11.08.2025 ,me të cilin është vendosur për ankesën A.nr.1145/2025, të datës 16.06.2025, të parashtruar nga ankuesja V.M.

II.Korrigjimi i këtij vendimi bëhet në preambulën e këtij vendimi ,nga se është bërë lëshim teknik ashtu që gabimisht është vendosë emri i Institucionit ndaj të cilit është bërë ankesa , pra në vend të organit të punësimit **Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve** është vendosë Ministria e Punëve të Brendshme ,si dhe në pjesën e fundit ku adresohet institucioni që i dërgohet ky vendim në vend të Ministria e Punëve të Brendshme duhet të jetë **Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve**.

III. Ndërsa dispozitivi i vendimit A.nr.1145/2025 i datës 11.08.2025,arsyetimi dhe pjesët tjera të vendimit që nuk janë pjesë e korrigjimit sipas këtij vendimi mbeten të pandryshuara.

IV. Ky vendim korrigjues është pjesë përbërëse e vendimit A.nr.1145/2025 të datës 11.08.2025.

A r s y e t i m

Kolegji i këshillit në ndërkohë pas komunikimit me Institucionin përkatës ndaj të cilit adresohet ankesa ka vërejtur se është bërë lëshim teknik ashtu që gabimisht është vendosë emri i Institucionit ndaj të cilit është bërë ankesa, pra në vend të organit të punësimit Ministria e Punëve të Brendshme duhet të jetë **Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve**,si dhe në pjesën e fundit ku adresohet institucioni që i dërgohet ky vendim në vend të Ministria e Punëve të Brendshme duhet të jetë **Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve** , andaj edhe mbi këtë bazë është bërë korrigjimi i

Numëri i lëndës A.nr.1145/2025
Datë: 24.09.2025
Numri i protokollit: 5383/2025

të njëjtë. Bazuar në këto rrethana, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 50 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1145/2025, datë 24/09/2025.

Flakron GASHI

Arben MEHMETI

Procesmbajtës

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses V.M;
- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore) si dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.